



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:263685  
Datë: 17.10.2024  
Numri i dokumentit: 06311979

**C-IV-14-2263**

*Ankuesi*

**I I**, Rahovec.

**Kundër**

*E paditura*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Driton Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

**Për: Palët**

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Sylejman Shumolli, me 15 tetor 2024, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. **REFUZOHET** ankesa si e pabazuar dhe **VËRTETOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit nr. PRZ012-0642 datë 28 shkurt 2014, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.
- II. Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 02 prill 2014, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, ankesë kundër Vendimit nr. PRZ012-0642 datë 28 shkurt 2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), me të cilin i ishte refuzuar si e pavlefshme kërkesa për kompensim për paga të papaguara për muajt janar, nëntor e dhjetor 2004 dhe janar e shkurt 2005 në shumën prej 59.40 € nga NSH “18 Nëntori”- Rahovec (*në likuidim*). Ankuesi pohoi se shkelja është bërë ngase organi i shkallës së parë respektivisht zyra e AL është dashtë personalisht ti kërkoj atij sqarim në lidhje me kërkesën e tij monetare nr. PRZ012-0642 respektivisht borxhit të ndërmarrjes ndaj tij për pagat e papaguara në shumën prej 59,40 € andaj nuk mundem ai ti ketë pasojat kinse për shkak të mos veprimit të ish drejtorit të financave ose mbas afatit. Shkelje tjetër është bërë nga organi i shkallës së parë se ka konstatuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë gjendjen faktike pasi ai kërkon nga AL borxhin që ia ka ish ndërmarrja ku ka punuar më parë, këtë fakt e din mirë AKP (AKM) Zyra Regjionale në Prizren, pasi që për çdo muaj është raportuar gjendja financiare e ndërmarrjes. Ankuesi më tej pohoi se është bërë shkelje nga organi i shkallës

së parë respektivisht nga AL pasi gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale duke ia refuzuar të drejtën e tij legjitime nga të ardhurat personale të papaguara, organi i shkallës së parë duke u bazuar në rregulloren e UNMIK-ut është dashtë me e aprovua kërkesën e tij. Ankuesi në mbështetje të ankesës së tij ka bashkangjitur vetëm vendimin e kundërshtuar.

Me 04 shtator 2023, e paditura në mbrojtjen e saj të parashtruar kundër ankesës, pohoi se i përmbahet qëndrimit se AL ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat e zbatueshme ligjore gjithashtu janë zbatuar saktësisht. E paditura thekson rregullin bazik të procedurës civile kontestimore sipas të cilit pala kërkuese (parashtruesi) ka detyrimin dhe barrën e provës (Neni 7 i LPK-së dhe Neni 31 i Ligjit 06/L-086). Një rregull i tillë është shprehimisht i paraparë edhe në nenin 23.2.3 dhe 23.2.4 të Shtojcës së Ligjit 04/L-034. E paditura konsideron se është e rëndësishme të theksohet se objekt i kësaj procedure gjyqësore është vetëm ligjshmëria (përputhshmëria me Ligjin 04/L-034) e vendimit të AL. Në këtë kontekst, neni 74.2 i Ligjit 06/L-086 parashikon që ankesat e dorëzuara në DHPGJS kundër vendimeve të AL duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L-034 për AKP-në. Parashtruesi jo vetëm që nuk ka arsyetuar dhe përmendur në ankesë ndonjë shkelje të mundshme të dispozitave të Ligjit nr. 04/L-034, por mbi të gjitha tejkalon çështjet e shqyrtuara në vendim dhe më tepër merret me akuza të pabazuara. E paditura më tej shton se kërkesa e ankuesit është pjesë e kërkesës kolektive (PRZ012-0006) parashtruar në AKP me datë 29 maj 2008 nga Xh D. Kjo kërkesë është dorëzuar brenda afatit të përcaktuar i cili ishte 31 maj 2008. Pas shqyrtimit paraprak që AL kreu, u vërejt se autorizimi për përfaqësimin e punonjësve të NSH nuk ishte i vlefshëm sipas ligjeve në fuqi. Për këtë arsye me datë 15 mars 2013 AL e ftoi parashtruesin e kërkesës të dërgonte një autorizim ligjor të vlefshëm brenda 15 dite nga pranimi i shkresës. Parashtruesi e pranoi shkresën me 21 mars 2013 dhe nuk iu përgjigj asaj brenda afatit 15 ditor i cili përfundoi me 04 prill 2013. Andaj, AL vendosi ta shqyrtoj këtë kërkesë në mënyrë individuale. Për sa më sipër dhe në bazë të Nenit 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 për AKP-në, AL me të drejtë konstatoi se dëshmia e kërkesës e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës mbetet jo e plotë edhe pas kërkesës për dokumente shtesë. Neni i lartpërmendur parasheh: *“...elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij Ligji për refuzimin e një Kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë... Kërkesa apo pretendimi është i parashkruar sipas kufizimeve kohore të aplikueshme”*. Duke u bazuar në nenin 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar (publikuar në GZ nr. 53 të vitit 1976) i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/24, parashikon që *“pagesa e shumës së pagës apo rrogës, apo secilës kërkesë tjetër të punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës do të jetë e parashkruar për tre vjet*. Në bazë të dispozitave të mësipërme, kërkesa duhet të jetë paraqitur në gjykatë apo ndonjë autoritet kompetent brenda tre viteve nga momenti kur punonjësi pretendon se NSH-ja nuk ka përmbushur detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës. Në rastin konkret, kërkuesi pretendon se NSH-ja nuk i ka paguar pagat për janar, nëntor dhe dhjetor 2004 dhe janar e shkurt 2005. Nuk ka asnjë provë përpara këtij AL që parashtruesi e ka dorëzuar këtë kërkesë para ndonjë gjykate apo autoriteti tjetër kompetent brenda periudhës shkurt 2005 – shkurt 2008. Andaj, kjo kërkesë është parashkruar në shkurt 2008. E paditura i propozon gjykatës që të refuzoj ankesën si të pabazuar dhe të vërtetoj vendimin e AL në pajtim me nenin 74.4 të Ligjit Nr. 06/L-086. AL në mbështetje të mbrojtjes së saj ka bashkangjitur vendimin e kundërshtuar dhe Vendimin për Emërimin / Përbërjen e Anëtarëve të AL-së DM 983/2022 datë 1 nëntor 2022.

Me 22 gusht 2024, gjykata lëshoi një urdhër për ankuesin duke kërkuar prova relevante në mbështetje të ankesës. Me 27 gusht 2024, urdhri u pranua nga ankuesi por asnjë përgjigje nuk u dorëzua.

Për detaje të tjera, referimi mund të bëhet në dosjen e lëndës.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet vendimi i AL si i drejt dhe i bazuar në ligj.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrirat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Gjykata vlerëson se kërkesa e ankuesit sipas vendimit të kundërshtuar të AL nr. PRZ012-0642 datë 28 shkurt 2014, për kompensim për paga të papaguara për muajt Janar, Nëntor, Dhjetor 2004 dhe Janar e Shkurt 2005, në shumë prej 59.40 € nga NSH “18 Nëntori”, nuk është e mbështetur në prova dhe si e tillë është e pabazuar. Ankuesi nuk ka ofruar asnjë dëshmi relevante në procedurë të likuidimit, por as në kohën e parashtrimit të ankesës në gjykatë kundër vendimit të AL, me të cilat do të mund të dëshmonte se ka ofruar shërbime / punë për NSH dhe se NSH detyrohet për kompensimin e pagave të pretenduara si të papaguara. Ankuesi vetëm e ka caktuar periudhën për të cilën kërkon pagat. Gjykata gjen se në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për paga të papaguara nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si e tillë kërkesa për paga është refuzuar si e pabazuar. Për më tepër ankuesi ka dështuar që të parashtrtojë prova në mbështetje të kërkesës së tij edhe

pas urdhrorit të gjykatës për të dorëzuar prova relevante në mbështetje të pretendimeve të tij ankimore, duke zgjedhur të mos përgjigjet në të njëjtin.

Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet e tjera të ankuesit në lidhje me objektin e kontestit, por gjen se të njëjtat nuk kanë efekt për të vendosur ndryshe në këtë çështje.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

### **Taksat gjyqësore**

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Në pajtim me nenin 13.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, nuk caktohen taksa gjyqësore, në këtë procedurë ankimore, pasi që vlera e objektit të kontestit është nën 1,000 €.

### **Këshilla juridike**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Sylejman Shumolli  
Gjyqtar